



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja Nr. 43
Prishtinë, më 30.09.2010, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Petar Miletić, Sanije Aliaj, Müfera Şinik, Rexhep Hoti, Sadik Idriz, Xhevdet Neziraj, Numan Balić, Zylfi Merxha, Hafize Hajdini, Hetem Arifi dhe.

Munguan: Enis Kervan, Dragiša Mirić dhe Mursel Haljilji.

Në mbledhje prezantuan: Nuk ka marr pjesë asnjë përfaqësues.

Nga Stafi Mbështetës: Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Petar Miletić, kryetari i Komisionit

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

Kryesuesi- konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen vetëm me një pikë të rendit të ditës.

1. Shqyrtimi i Projektligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës me raportin e komisionit funksional – Komisioni për buxhet dhe financa, me amendamente;

Kryesuesi- dha sqarim se mbledhja e sotme është thirrur me kërkesë të kryeparlamentarit të Republikës së Kosovës, dhe se Komisioni për Komunitete dhe Kthim, si komision i përhershëm është i obliguar që urgjentisht të procedojë këtë Projektligj.

Kryesuesi- konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me shumicë votash, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës dhe ka konstatuar se projektligji dhe amendamentet nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

Mbledhja përfundoi në orën 10:15

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,

Petar Miletic